



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2559/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI238/23

Parashtrues

Simon Raja, Elvane Qafani, Elvane Imeraj dhe Arjeta Marku-Metaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 263/23 të Gjykatës
Supreme të Kosovës të 12 korrikut 2023**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Simon Raja, Elvane Qafani, Elvane Imeraj dhe Arjeta Marku-Metaj, që të gjithë nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), i përfaqësuar nga Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Rev. nr. 263/23] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 12 korrikut 2023 (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) dhe Aktgjykimin [Ac.nr.45/19] të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës të 25 janarit 2023 (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. .

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 tetor 2023, parashtruesit e kërkesës përmes postës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 30 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR.KI238/23] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe përmes vendimit [Nr. KSH.KI238/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 7 nëntor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga të njëjtit kërkoi që ta plotësojnë formularin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 21 nëntor deri 22 dhjetor 2023, parashtruesit e kërkesës dorëzuan formularët e plotësuar.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 1 tetor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Nga shkresët e lëndës rezulton se punëdhënësi spitali rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: pala e paditur) u kishte mohuar parashtruesve të kërkesës ngritjen e koeficientit (si bazë e përcaktimit të të ardhurave prej 4.8 në 5.4, siç iu paguhet të gjitha qendrave tjera shëndetësore të Kosovës, në QKUK-Shërbimet e Kujdesit Intensiv Kirurgjik. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë tek komisioni për verifikimin e koeficientit të të ardhurave personale, por nuk morën përgjigje. Parashtruesit e kërkesës iu drejtuan Ministrisë së Shëndetësisë Zyra Ligjore, mirëpo nuk morën përgjigje. Parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër palës së paditur ashtu që e njëjta t'iu pranoi ngritjen-rregullimin e koeficientit të pagës nga 4.8 në 5.4 si bazë e të ardhurave personale dhe që secilit parashtrues të kërkesës t'ia kompensojë shumën prej 37.18 euro në muaj duke filluar nga data 01.08.2018 e tutje.
13. Më 2 nëntor 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [C.nr.341/17] vendosi: MIRATOHET kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës ashtu që DETYROHET pala e paditur që parashtruesve të kërkesës t'iu pranoi ngritjen-rregullimin e koeficientit të pagës nga 4.8 në 5.4 si bazë e të ardhurave personale dhe që secilit parashtrues të kërkesës t'ia kompensojë shumën prej 37.18 euro në muaj duke filluar nga data 01.08.2018 e tutje DETYROHET pala e paditur që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, t'i paguajë pagat mujore diferencën e koeficientit nga 4.5 në 5.4 nga periudha kohore prej datës 25.01.2010 deri 30.07.2018 për parashtruesit e kërkesave Simon Raja, Elvane Qafani dhe Elvane Imeraj si dhe për periudhën 25.01.2010 deri 15.05.2012 për parashtruesen e kërkesës Arjeta Marku-Metaj, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm DETYROHET pala e paditur që parashtruesve të kërkesës t'iu paguaj shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Gjykata Themelore kishte theksuar se pozita e infermierit të kujdesit intensiv si në ratin e parashtruesve të kërkesës është paguar nga pala e paditur me koeficient më të ulët dhe se duhet të pranohet që kërkesëpadija dhe të obligohet pala e paditur që parashtruesve të kërkesës t'ua paguajë me koeficient të ri duke ua kompensoar pjesën e ndryshimit për çka kishte vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.
14. Në një datë të paspecifikuar, pala e paditur parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës të refuzohet në tërësi.
15. Më 25 janar 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.54/19] vendosi **APROVOHET** e bazuar ankesa e palës së paditur ndërsa ndryshohet Aktgjykimi [C.nr.341/17] i Gjykatës Themelore i 2 nëntorit 2018 dhe **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës me të cilën kanë kërkuar që pala e paditur t'iu pranoi ngritjen-rregullimin e koeficientit të pagës nga 4.8 në 5.4 si bazë e të ardhurave personale dhe që secilit parashtrues të kërkesës t'ia kompensojë shumën prej 37.18 euro në muaj duke filluar nga data 01.08.2018 e tutje.
16. Gjykatat e Apelit vlerësoi: (i) gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore (ii) për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, sepse parashtruesit e kërkesës kanë lidhur kontrata individuale me palën e paditur dhe këto kontrata janë respektuar e në bazë të tyre të njëjtit janë paguar nga pala e paditur, e cili fakt me rëndësi nuk kontestohet nga palët ndërgjyqëse; (iii) pra

parashtruesit e kërkesës për kryerjen e detyrave të punës janë paguar nga e pala e paditur konform kontratave të punës të lidhura me secilin parashtrues të kërkesës veç e veç; (iv) në rastin konkret kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar, për faktin se kontratat të cilat i kanë lidhur me palën e paditur janë lidhur konform dispozitës së nenit 11 (Përmbajtja e Kontratës së Punës) të Ligjit Nr 03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i Punës), pasi që të njëjtat i përmbajnë të gjitha elementet që do duhej t'i përmbante një kontrate e punës; (v) e po ashtu parashtruesit e kërkesës këto kontrata i kanë lidhur me vullnetin e tyre e që dëshmohet edhe me nënshkrimet e tyre, me ç'rast konstatohet se parashtruesit e kërkesës janë pajtuar që për kompensim të pranojnë pagën në lartësi të koeficientit 4.8.; (v) në anën tjetër, Gjykata e Apelit konstatoi se nuk është vërtetuar se kontratat të cilat janë lidhur mes palëve ndërgjyqëse, me aktin e brendshëm të palës së paditur dhe as me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD) edhe përkundër pretendimeve të parashtruesve të kërkesës se kontratat i kanë nënshkruar nën kërcënimin e largimit nga puna për faktin se të njëjtit nuk kanë prezantuar asnjë provë materiale për të vërtetuar pretendimet e tyre në kuptim të nenit 7 lidhur me nenin 319.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK) që do të shpinte Gjykatën e Apelit në konstatimin se kontratat janë nënshkruar nën kërcënimin e largimit nga puna e rrjedhimisht janë kontrata nule apo të rrëzueshme, sipas LMD-së; (vi) sipas vlerësimit përfundimtar të Gjykatës së Apelit, rezultoi se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar e ka aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës si të bazuar ndaj palës së paditur, sepse kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës nuk ka bazë juridike, përkatësisht parashtruesit të kërkesës-me palën e paditur, me vullnetin e tyre kanë lidhur kontratë të punës, e cila nuk është kontestuese se është përmbushur; (vii) prandaj, Gjykata e Apelit vendosi që ta aprovojë ankesën e palës së paditur, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar dhe ta refuzojë në tërësi si të pathemeltë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimin i gjykatës së shkallës së dytë dhe të refuzohet ankesa e palës së paditur duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.
18. Më 12 korrik 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.263/2023] refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës Simon Raja, Elvane Qafani dhe Elvane Imeraj të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac.nr.54/19] të Gjykatës së Apelit të 25 janarit 2023, ndërsa revizioni i parashtrueses së kërkesës Arjeta Marku-Metaj, kundër të njëjtit aktgjykim, hedhet si i palejuar. Gjykata Supreme vlerësoi se parashtruesit e kërkesës dhe pala e paditur, kanë lidhur me vullnetin e tyre të ndërsjellë edhe kontratat e punës me çka, veç tjerash, kanë themeluar marrëdhënien e punës, ashtu që parashtruesit e kërkesës, me vullnetin e tyre kanë pranuar kushtet e përcaktuara, përfshirë edhe pagën.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimin i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së.
20. Parashtruesit e kërkesës në përgjithësi përshkruajnë zhvillimin e procedurave në tri shkallët e gjyqësorit të rregullt dhe pretendojnë: *“Konsideroj se aktgjykimet e shkallës së II dhe shkallës së III janë në kundërshtim me njoftimin e ministrisë së shëndetësisë*

dhe departamentit ligjor të datës 30.05.2018. Po ashtu të njëjtë aktgjykime të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme janë në kundërshtim me nenin 55 para.1 dhe 2 të ligjit të punës si dhe nnin 88.1 para.1 të të njëjtit ligj. ”

21. Parashtruesit e kërkesës më tej pretendojnë se vendimet e kontestuara të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të punës dhe të LMD-së.
22. Në kontekst të pretendimeve të mësipërme parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë se ka pasur shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës; (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev.nr.263/2023] të Gjykatës Supreme të 12 korrikut 2023 dhe Aktgjykimin [Ac.nr.54/19] të Gjykatës së Apelit të 25 janarit 2023.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim.*
2. *Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
3. *Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

Neni 46

[Mbrotja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

Neni 5
Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

“1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate.

3. Nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

4. Punëdhënësi është i obliguar që në rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj.

5. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/3 Kundër Diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.”

Neni 10
Kontrata e Punës

“1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuari. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Kontrata e Punës mund të lidhet për:

2.1. një periudhë të pacaktuar;

2.2. një periudhë të caktuar; dhe

2.3. për punë dhe detyra specifike.

3. Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar.

4. Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite.

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

6. Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

7. Personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

8. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës.

9. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me këtë ligj.”

Neni 55

Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera

“1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit .

2. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

3. Punëdhënësi duhet t'i paguajë femrave dhe meshkujve kompensimin e njëjtë për punën e vlerës së njëjtë, kompensim i cili mbulon pagën bazë dhe shtesat e tjera.

4. Punëdhënësi duhet të nxjerrë një deklaratë për çdo pagesë dhe çdo shtesë tjetër të paguar të të punësuarve. Pagat mund të paguhen përmes transferit bankar ose me para të gatshme me ç'rast punëdhënësi duhet të mbajë regjistrin për pagesat e bëra.

5. Pagat në Kosovë paguhen sipas valutës zyrtare në Euro (€).

6. Paga, paguhet në afatet e përcaktuara me Kontratë Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ose Kontratën e Punës, më së paku një (1) herë në muaj.”

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 211

Pa titull

“211.1 Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën u është dorëzuar aktgjykimi.

211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpapia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.

[...].”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 (Kërkesat individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

26. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.nr.263/2023] të 12 korrikut 2023 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve të parashikuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
27. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 34 (2) përcakton:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
28. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26, shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
29. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).
30. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
31. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet se faktin se punëdhënësi spitali rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë përkatësisht pala e paditur u kishte mohuar parashtruesit të kërkesës ngritjen e koeficientit (si bazë e përcaktimit të të ardhurave prej 4.8 në 5.4, siç iu paguhet të gjitha qendrave tjera shëndetësore të Kosovës, në QKUK-Shërbimet e Kujdesit Intensiv Kirurgjik. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë tek komisioni

për verifikimin e koeficientit të të ardhurave personale dhe tek Ministria e Shëndetësisë, mirëpo nuk morën përgjigje. Parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në Gjykatën Themelore kundër palës së paditur ashtu që e njëjta t'iu pranoi ngritjen-rregullimin e koeficientit të pagës nga 4.8 në 5.4 si bazë e të ardhurave personale dhe që secili parashtrues të kërkesës t'ia kompensojë shumën prej 37.18 euro në muaj duke filluar nga data 01.08.2018 e tutje. Gjykata Themelore miratoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës dhe detyroi palën e paditur që parashtruesve të kërkesës t'iu pranoi ngritjen-rregullimin e koeficientit të pagës nga 4.8 në 5.4 si bazë e të ardhurave personale dhe që secili prej tyre të kompensohet me shumën që iu takon. Pala e paditur parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës të refuzohet në tërësi. Gjykata e Apelit aprovoi të bazuar ankesën e palës së paditur dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe refuzoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës. Parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të refuzohet ankesa e palës së paditur duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Supreme refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës Simon Raja, Elvane Qafani dhe Elvane Imeraj të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa revizioni i parashtrueses së kërkesës Arjeta Metaj-Marku, kundër të njëjtit aktgjykim, e hodhi të palejuar. Gjykata Supreme vlerësoi se parashtruesit e kërkesës dhe pala e paditur, kanë lidhur me vullnetin e tyre të ndërsjellë edhe kontratat e punës me çka, mes tjerash, kanë themeluar marrëdhënien e punës, ashtu që parashtruesit e kërkesës me vullnetin e tyre kanë pranuar kushtet e përcaktuara, përfshirë edhe pagën.

32. Gjykata vëren se parashtruesit i kërkesës në përgjithësi përshkruajnë procedurat e zhvilluara pranë gjyqësorit të rregullt dhe se vetëm nominalisht pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së si dhe nenin 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së.
33. Në këtë drejtim, Gjykata vë në spikamë arsyetimin e Gjykatës Supreme: *“Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes konkrete juridiko civile, pranon si të themeltë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, lidhur me refuzimin si të pathemeltë të kërkesëpadisë së paditësve përkitazi me pagesën e diferencës së pagës, nga se aktgjykimet e instancave më të ulta nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes për rastin konkret juridiko civil, ka marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Fakt relevant është se paditësit dhe i padituri, kanë lidhur me vullnetin e tyre të ndërsjellë edhe kontratat e punës me çka, veç tjerash, kanë themeluar marrëdhënien e punës, ashtu që paditësit, me vullnetin e tyre kanë pranuar kushtet e përcaktuara, përfshirë edhe pagën, dhe duhet theksuar, se ky raport midis tyre nuk ka ndryshuar me veprime të njëanshme të paditurit, por është bërë me kontratën e punës si vepër e shprehjes së autonomisë së vullnetit të palëve në rregullimin e raportit përkatës të punës, gjë që, edhe sipas mendimit të kësaj Gjykate, kjo bie ndesh me dispozitat e nenit 10 etj, të Ligjit të Punës. Gjykata Supreme vlerëson se me nenin 55 para. 1 të Ligjit të Punës është caktuar se i punësuarit ka të drejtë në pagë e cila caktohet me kontratë të punës në pajtim me këtë Ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Në rastin konkret kjo*

është zbatuar nga ana e punëdhënësit dhe mbi këtë bazë edhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm ndërsa pretendimet e revizionit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla refuzohen si të pa bazuara. Gjykata Supreme e Kosovës, për sa i përket paditëses Arjeta Marku-Meta, në kuptim të nenit 211.2 të LPK-së, shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së revizionit, dhe gjeti se për sa i përket të njëjtës, revizioni është i palejuar. Kjo për arsye se me nenin 211.2 të LPK-së, parashikohet se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit, në pjesën e goditur të aktgjykimit, nuk e kalon shumën prej 3.000 €. Për faktin se me revizion është goditur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, për kompensimin e dëmit të gjykuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket paditëses Arjeta Marku-Meta, për shumën e përgjithshme prej 706.53 €, e cila nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 211.2 të LPK, vetëm për paditësen e lartpërmendur, në rastin konkret gjithnjë duke pasur për bazë faktin se palët janë bashkëndërgjygjës të thjeshtë, revizioni në këtë çështje juridike sa i përket paditëses Arjeta Marku-Meta nuk është i lejuar dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë.”

34. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se në procedurën zhvilluar sipas revizionit: (i) Gjykata Supreme mbi bazën e dispozitave përkatëse materiale të Ligjit të punës ka vlerësuar se parashtruesit të kërkesës me vullnetin e tyre kanë lidhur kontratë pune me palën e paditur dhe janë pajtuar me të gjitha kushtet e përcaktuara në kontratë përfshitë dhe koeficientin e pagës; (ii) Gjykata Supreme kishte theksuar se kontrata e punës së parashtruesve të kërkesës po ashtu ishte zbatuar nga pala e paditur në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit të Punës dhe LMD-së; (iii) Gjykata Supreme po ashtu kishte konstatuar se njëri nga parashtruesit e kërkesës nuk i plotëson kushtet për të paraqitur revizion në pajtim me dispozitat përkatëse të LPK-së.
35. Në kontekst të interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga Gjykata Supreme, Gjykata pohon sërish se nuk është detyrë e saj që të vlerësojë korrektësinë e interpretimit dhe zbatimit të dispozitave procedurale dhe materiale të ligjit në fuqi nga gjykatat e rregullta. Detyrë e Gjykatës është që të vlerësojë nëse gjykatat e rregullat kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në pajtim me garancitë themelore të mishëruara në Kushtetutë, KEDNJ dhe marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në sistemin juridik kosovar bazuar në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka interpretuar dhe zbatuar dispozitat materiale të Ligjit të Punës në pajtim me garancitë themelore të mishëruara në Kushtetutë dhe marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në sistemin juridik kosovar.
36. Sërish lidhur me çështjen e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, Gjykata përsëritë se sa i përket gjyqësorit të rregullt, Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (shih neni 103.2 i Kushtetutës) dhe se interpretimi i saj i dispozitave përkatëse ligjore dhe çështjeve tjera të ligjit mbizotëron ndaj interpretimeve ligjore të gjykatave të instancës më të ulët si dhe ndaj vet palëve ndërgjyqëse. Në rastin konkret, vlerësimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore është në përputhje me garancitë procedurale nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 (1) i KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës [KI37/21](#) parashtrues *Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafi 65 dhe referencat e përmendura aty; po ashtu shih [KI156/22](#) parashtrues *“Thermo SHPK”*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2023, paragrafi 58).
37. Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe relevante të mbështetur në bazë ligjore specifike dhe mjaftueshëm të parashikueshme për të

konstatuar se parashtruesit të kërkesës janë kompensuar nga punëdhësi i tyre në përputhje me kushtet e kontratës të lidhur me vullnetin e tyre të lirë dhe me dispozitat e Ligjit të Punës; dhe se, në këto rrethana Gjykata Supreme ka përmbushur obligimin për nxjerrje të vendimit të arsyetuar mbështetur në bazë ligjore të parashikueshme, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

38. Në kontekst të pretendimit për diskriminim, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar apo identifikuar individin apo grupin në krahasim me të cilin është diskriminuar dhe me të cilin ata kanë qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme. Barra e të provuarit për trajtim diskriminues bie mbi parashtruesit e kërkesës çka bazuar në shkresat e lëndës është evidente se pretendimin për diskriminim ata nuk e kanë provuar. (shih rastet e Gjykatës [KI16/22](#) parashtrues *Hamit Gashi*, aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2022, paragrafi 57; dhe [KI59/23](#), parashtrues, *Fehmi Grajçevci*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 gushtit 2023, paragrafi 54).
39. Duke vlerësuar procedurat e zhvilluara në tërësi në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës përfituan nga procedura kontradiktore dhe se ata ishte në gjendje të paraqesin në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ata i konsideruan të rëndësishme për rastin e tyre; ata kanë pasur mundësinë të hedhin poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tyre, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
40. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore siç garantohen me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 (1) dhe 14 të KEDNJ-së, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe duhet të refuzohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç specifikohet në rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
41. Për sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk do t’i nënshtrohet vlerësimit kushtetues për shkak se nuk ngre ndonjë çështje të re që nuk është vlerësuar më parë në kuadër të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës [KI107/22](#) parashtrues *Valdet Avdiu*, cituar më lart, paragrafi 50; [KI59/23](#), parashtrues, *Fehmi Grajçevci*, cituar më lart, paragrafi 57).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 1 tetor 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani